BULETINI VIII GUSHT 2019

MiniMaratona “Vrapojmë për Dije”

Me 31 gusht, me moton “Vrapojmë për Dije”, është mbajtur minimaratona humanitare për të ndihmuar shkollimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Të gjitha ata që kanë marrë pjesë në këtë minimaratonë është dashur që të blejnë një numër i cili ka kushtuar 5 euro, ku pastaj të gjitha mjetet e mbledhura do të shkojnë në qendrat mësimore për mësim shtesë, të menaxhuara nga organizata “Zëri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve”.

Në MiniMaratonën prej 5km kanë qenë pjesmarrës reth 200 persona të cilët iu janë bashkuar kësaj kauze "Vrapo për Dije" të organizuar nga Ojq-VoRAE në bashkëpunim me Federaten e Atlentikës së Kosovës dhe Komunën e Prishtinës.

MiniMaratona ka qenë e ndarë në dy kategori për fëmijë (femra- meshkuj) me vrapim 1km (vajtje, ardhje) dhe kategoria për të rritur (femra - meshkuj) me vrapim 5km (vajtje, ardhje).

Nga kjo janë ndarë gjithsej 12 shpërblime, për secilen kategori nga tre çmime si: vendi i parë , i dytë dhe i tretë.

Padyshim ky aktivitet nuk ka mundur të realizohet pa sponsor të cilët kanë dhënë kontributin e tyre: Ujë Rugova, Pit Poëer, HotelGracanica.

Falënderim i veçant shkon edhe për Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, dhe Policinë e Kosovës.

Ojq- VoRAE gjithashtu falenderon në menyrë të veçant personat të cilët kanë mbeshtet këtë kauz: znj. Saranda Bogujevci, z.Veton Berisha, z.Artan Berisha, z.Burim Krasniqi, mediat dhe stafin e palodhshem të organizatës VoRAE në krye me organizatorin z.Orhan Butic me stafin e tij dhe tutorët e qendrave mësimore për mësim shtesë.

Urojm që kjo kauz në vitet në vijm të jetë edhe më gjithëpërfshirëse duke parë rëndësin dhe qellimin e saj për Dije dhe ndihmën për vazhdim shkollimi të metutjeshëm për këto tri komunitete: rom, ashkali dhe egjiptian

EDI - Faza 3 - Fuqizimi i komuniteteve jo-shumicë në Kosovë përmes arsimit, dialogut dhe përfshirjes në proceset e vendimmarrjes komunale

Është lansuar faza e tretë e projetit EDI, i cili financohet nga Agjencioni Austriak për Zhvillim.

Projekti do te implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Balkan Sunfloëers, The Ideas Partnership dhe PLAY International Kosova. Qëllimi kryesor i projektit është përfshirja e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, përmes arsimit cilësor dhe kohezionit social. Duke u bazuar në sukseset dhe arritjet e EDI 1 (2013-2016) dhe EDI 2 (2016-2019), faza e tretë do të synojë të krijoj themele të forta për gjithëpërfshirje përmes institucionalizimit dhe avokimit.

Konsorciumi i projektit do të implementoj projektin e hartuar për të mbuluar tre fusha kryesore, të gjitha këto do të mbështeten me punën e vazhdueshme të avokimit me aktorët kryesorë:

1) Përmirësimi i Qendrave Mësimior dhe programeve sportive të cilat kontribuojnë në cilësinë e arsimit dhe kohezionit social për fëmijët në katër lokalitete të synuara;

2) Ngritja e kapaciteteve për mësuesit, stafin e qendrave mësimore dhe vullnetarët për të siguruar që ata janë të kualifikuar, të përkushtuar dhe të motivuar për të siguruar arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor;

3) Regjistrimi zyrtar i katër Qendrave Mësimore dhe dorëzimi i dy Qendrave Mësimore në institucionet e Kosovës duke i bërë ato të qëndrueshme financiarisht dhe aktive përtej përfundimit të projektit.

Aktivitet e projektit do t'i pergjigjen nevojave te komuniteteve në katër komuna: Fushë Kosovë, Lipjan, Shtime dhe Obiliq. Afati kohor i implementimit të projektit EDI 3 është deri në Korrik 2022.

Renovim në Qendrën Mësimore në Mitrovicë

Projekti "Përkrahja e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2 – Arsim për Integrim" (EU SIMRAES 2) i cili financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndërsa zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), KFOS dhe 6 organizata të shoqërisë civile, me datë 22 gusht ka bërë renovimin e Qendrës Mësimore të RADC Roma Mahalla në Mitrovicë . Renovimi në këtë qendër ka përfshirë rregullimin e dyerve dhe dritareve, ndërrimin e dyshemesë në dy klasa si dhe ngjyrosjen e mureve të brendshme të Qendrës.
Përmes këtij renovimi është krijuar një ambient më i përshtatshëm për punë dhe për shërbime cilësore për fëmijët e këtyre komuniteteve.

Shkolla verore 3-ditëshe për mësimdhënës të gjimnazeve partnere

Në kuadër të Programit "Përkrahje Adoleshentëve pas Mësimit të Rregullt"-ASSET, me datë 22 gusht është mbajtur shkolla verore 3-ditëshe për mësimdhënës të gjimnazeve partnere. Synimi i kësaj shkolle ka qene që mësimdhënësit e fushave të ndryshme të zbatojnë përdorimin e pajisjeve të teknologjisë arsimore në mësimdhënie dhe në projekte shkollore. Përmes punëtorive të shkurtra, pjesëmarrësit fituan njohuri praktike për përdorimin e pajisjeve si: Arduino/Elektronikë, PocketLab, mikroskopi elektronik, CNC ruteri, 3D Printeri, prerësi

laserik dhe makina qepëse kompjuterike.

Programi ASSET financohet nga USAID, ndërsa zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me FHI360 dhe Crimson Capital Corp.

EPRBM mban takim në qendrën mësimore në Plemetin

Me 30 gusht, në Qendrën e mësimit shtesë të BSFK në Plemetin , Ekipi për Parandalim,Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimt të nxënësve në shkollë në nivel komunal mbajti takimin e punës me prindër të fëmijëve të komunitetit ashkali ,romë dhe egjiptian. Në këtë takim u fol për vijushmërinë e rregullt në arsimin parauniversitar dhe indendifikimin e atyre nxënësve të cilët e kanë braktisur mësimin për shkaqe ekonomike .

Në këtë takim u informuan prindërit për bursa dhe konpenzimin e rrugës që sivjet komuna e Obiliqit përkatësisht Drejtoria Komunale e Arsimit do t'u ndihmojë .Në fund të këtij takimi prindërit u njoftuan për fëmijët të cilët e kanë braktisur mësimin e rregullt dhe tani janë 17-18 vjeç ata mund ta ndjekin mësimin jo formal prej kl: 1-9 në Shfmu:"Dr. Ibrahim Rugova" në Obiliq.

Të pranishëm në këtë takimi ishin : znj.Fatime Beka Pllana, shefe komunale e arsimit, njëherit kryesuese e EPRBM, Bedri Neziri, drejtor i Shfmu:"Pandeli Sotiri" se bashku me mësueset: Zojnie Mehmeti e Azize Shaljani, Miranda Fondaj ,dhe Nazmije Hoxha nga Qendra për mësim shtesë në Plemetin .

Pas këtij takimi drejtori i shkollës se bashku me anëtarët e ekipit EPRBM vizituan objektin shkollor dhe Kompanin N.N.P. "Ndëtimtari " të cilët i kanë përfunduar punimet ne afatin rekord në rregullimin e oborrit më kubëza nga pllatoja para objektit shkollor e deri të parkingu. Ky projekt u financua nga komuna e Obiliqit.

Fushatë për regjistrimin e fëmijëve të komuniteteve Rom, Egjiptian dhe Ashkali në shkolla

Gjatë muajit Gusht janë realizuar fushata avokuese për regjistrimin e fëmijëve në shkollë në kuadër të projektit EU Simraes II, ku gjatë kësaj fushate janë realizuar takime me prindër të fshatrave Sërbobran dhe Gurrakoc në lokalitete në të cilat realizohet programi në kuadër të shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Martin Camaj" në Gurrakoc.

Kampi Veror 2019

Më 7,8 dhe 9 gusht 2019, është realizuar një kamp veror me nxënësit e 6 shkollave fillore të komunave të Pejës, Klinës dhe Istogut. Qëllimet e këtij kampi treditor në të cilin morën pjesë rreth 150 fëmijë, ishin: zhvillimi i shkathtësive intelektuale dhe fizike, stimulimi i ideve kreative punës në grup dhe socializimi dhe të mësuarit përmes lojës.

Gratë e Janjevës përfitojnë nga projekti ReLOaD

Në kuadër të projektit ReLOaD (Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor) ka filluar aktiviteti i përgatitjes së 15 grave të Janjevës për rrobaqepësi dhe punë artizanale përmes trajnimeve që do të udhëhiqen nga 5 gra të projektit mikrofinanciar Sa-punë. Pjesë e përgatitjes do të jenë edhe trajnimet mbi ndërmarrësinë dhe biznesin.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor, pjesë e të cilit është edhe projekti i cili po implementohet nga The Ideas Partnership në Janjevë, financohet nga Bashkimi Evropian në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit, dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e grave në biznes dhe rritjen e ndërgjegjësimit rreth pjesëmarrjes më të gjerë të të rinjëve të Janjevës në kulturë dhe sport.

Fëmijët vizitojnë Galerinë Kombëtare të Kosovës

Fëmijët nga komunitetet pakicë Rom, Ashkali dhe Egjiptian, që ndjekin mësimet intenzive në qendrën tonë në Fushë Kosovë, patën mundësinë që të vizitojnë Galerinë Kombëtare të Kosovës duke parë nga afër veprat e artistit Muslim Mulliqi e duke u inspiruar për të vizatuar vetë në ambientet e Galerisë.

Falenderime të shumta Galerisë Kombëtare të Kosovës që inicioi këtë bashkëpunim dhe mirënjohje stafit mikpritës të Galerisë që mirëpriti fëmijët tanë, u mësoi rreth artit dhe u dha mundësinë që të shohin nga afër një ekspozitë arti.

Trajnime për bujqësi

Në kuadër të projektit " Nxitja e të rinjëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që të merren me bujqësi" në Ferizaj, janë mbajtur trajnime me temat;

a. Hartimi i Projekteve
b. Hartimi i Biznes Planeve
c. Trajnime për perimet
d. Trajnime për pemët
e. Trajnime për blegtori
f. Trajnime për drithërat

Qëllimi i këtij projekti është që të rinjët të nxiten dhe inkurajohen që të merren me bujqësi dhe përmes trajnimit të rinjët kanë fituar njohuri bazike për bujqësin dhe degët e saja, njëherit kanë ngritur kapacitetet e tyre në hartimin e projekt – propozimeve dhe planeve të bizneseve.

Trajnim për të rinjtë punëkërkues

Në kuadër të projektit "Integrimi dhe perfshirja e komuniteteve minoritare në zhvillimin ekonomik" që përkrahet nga Enhancing Youth Employment- EYE Project dhe implementohet nga kompania ËELD Tech, po zhvillohet trajnimi me çertifikim ISO EN 9606-1 për 15 të rinjë punëkërkues nga komunitetet Ashkali dhe Rom në Ferizaj.Pas trajnimit këta te rinjë pritet të punësohen në kompanite private të metal perpunimit në rajonin e Ferizajit.

Projekti është duke u mbështetur dhe ndihmuar fuqishëm edhe nga OJQ Bashkimi Rinor E Ardhmja E Ndritur.

KIMERK është aty ku ndodh zhvillimi ekonomik.

Aktivitetet në Qendrën Mësimore në Mitrovicë

Nga 20 deri 25 gusht 2019, në Mitrovicë pas përfundimit të renovimit të Qendrës Mësimore në , , Lagjën Rome, fëmijët patën mundësi që pak para fillimit të vitit shkollor të kishin disa ditë për të shijuar aktivitetet e lira në QM Mitrovica. Këto aktivitete janë organizaur nga stafi i RADC te QM në kuadër të programit EU SIMRAES 2.

Takim nxitës për regjistrim në shkollat e mesme

Me datën 20 gusht në Prizren, OJQ Nevo Koncepti ka organizuar takim të përbashkët me prindërit dhe nxënësit e shkollave fillore të mesme të ulta.

Gjatë takimit, semimaturantëve u janë shpërndarë broshurat në lidhje me regjistrimin e tyre në shkolla të mesme të larta. Pos broshurave janë dhënë edhe informata shtesë lidhur me afatin e dytë të regjistrimit të nxënësve në shkolla të mesme. Gjatë takimit me nxënësit, ata u njoftuan për drejtimet të cilat ofrohen nga shkollat e mesme të larta dhe mundësitë që kanë për të zgjedhur me vetdëshirë.

Organizimi është realizuar në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian”, EU SIMRAES II, që zbatohet nga Nevo Koncepti.

Aktivitete me nxënësit në Piranë

Aktivitete psiko-sociale dhe të lira janë organizuar me datën 22 gusht 2019 me nxënësit e shkollës fillore të mesme të ulët "Dy Dëshmorët" në Piranë të Prizrenit.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë nxënës të etnive të ndryshme dhe grup moshave të ndryshme të kësaj shkolle. Qëllimi i aktivitetit ishte përfshirja e të gjithë fëmijëve të etnive të ndryshme dhe motivimi për pjesëmarrje në aktivitete të tjera në shkollë. Ky aktivitet ka paraparë si qëllim edhe ngritjen e interesimit të fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shkollë si dhe ndryshimin e qasjes në shkollë.

Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit "Mbështetja e BE-së për zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian", EU SIMRAES-II, që zbatohet nga Nevo Koncepti.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me Komunën e Prishtinës

Terre des hommes vazhdimisht ka dëshmuar përkushtimin ndaj ofrimit të shërbimeve kualitative dhe të specializuara për fëmijët në situatë rruge; për fëmijët të cilët gjenden ne rrezikshmëri të lartë si dhe për fëmijë viktima të abuzimit. Duke krijuar mundësi të reja të ofrimit të shërbimeve të specializuara dhe të urgjencës për këta fëmijë, përmes krijimit të Qendres Ditore, Terre des hommes sot ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me Komunën e Prishtinës. Ne jemi shumë të kënaqur, për mundësite që kjo qendër do të ofrojë për këta fëmijë dhe bashkëpunimin e frytshëm me Komunën e Prishtinës.

Programi veror i VoRAE

Programi i arsimit/ edukimit në OJQ-VoRAE ka filluar përsëri zbatimin e programit veror edhe këtë vit në 19 qendrat mësimore për mësim shtesë në Kosovë.

Programi veror është një përvojë sfiduese, e shëndetshme dhe e pasur, me aktivitetet edukative ku kontribuojnë në mënyrë konstruktive në zhvillimin personal të fëmijëve tonë. Fëmijët gjatë këtij programi veror e krijojn ndjenjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes për potencialin e tyre shkollor.

Programi veror u ofron nxënësve një verë të paharrueshme, ku ata zhvillojnë: aftësitë, njohuritë dhe mirëkuptimin e tyre në sport, përmirësimet gjuhësore dhe drejtshkrimore, punë ekipore, kulturë dhe çdo gjë tjetër të gjitha këto në një ambient argëtues dhe të pastër.

Kjo përvojë e të mësuarit, është zbulimi dhe zhvillimi sfidues dhe konstruktiv që ndahet me fëmijë nga prejardhje dhe kultura të ndryshme.